




PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2026

LËNDA EDUKIM FIZIK





TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE.....	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE TË METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE.....	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	9
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS.....	11



HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës edukim fizik është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit të edukimit fizik dhe të sporteve. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MA-ja ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- b) Programe lëndore të edukimit fizik dhe sporteve.
- c) Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënien e lëndës së edukimit fizik dhe sporteve.
- d) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- e) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- f) Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të edukimit fizik dhe sporteve.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MA-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës edukim fizik, sporte dhe shëndet është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe për zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor;
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësi shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të edukimit fizik, sporte dhe shëndet është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësuesi i lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar; Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojnë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** në funksion të tyre që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e	- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për

kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MA-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit; - njeh dhe zotëron platformën e edukimit fiziko- sportiv; - njeh dhe harton rezultatet e pritshme mbi të nxënësit e nxënësve, në varësi të programit ushtrimor të kësaj platforme;	numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 17, datë 22.07.2024. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. -Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	--

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të edukimit fizik dhe sporte në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me mjedisin e shkollës; - përdor me efikasitet mjetet e nevojshme, si dhe mjediset sportive për zbatimin e programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe zhvillimin e aftësive fizike të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin dhe zhvillimin fizik nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup tematikash ose nëntematikash në përputhje me kompetencat e programit; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të edukimit fizik dhe sporteve); - lidh edukimin fizik me sportet e tjera; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme	- Korniza Kurrikulare, 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. - Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X - XII.

për të realizuar përmbushjen e kompetencave; - siguron informacion që demonstroi lidhjen e edukimit fizik dhe sporteve me shkencat e tjera dhe me jetën reale.	
---	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE TË METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

Kompetenca I	
“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e edukimit fizik, sporte dhe shëndet”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikon nxënësit me aftësi të kufizuara (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar në sport); - planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nxënësit obezë; - demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së edukimit fizik dhe sporteve;	- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA, 2018. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019. - Udhëzuesi kurrikular lëndor në edukim fizik, sporte dhe shëndet, në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. - Udhëzuesi kurrikular lëndor në edukim fizik, sporte dhe shëndet, në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018. - Modele me detyra përmbledhëse dhe teste

- edukon te nxënësit dëshirën për t'u marrë me sport; - motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	për arsimin parauniversitar (Detyra përmbledhëse të hartuara nga mësuesit), Lënda: Edukim fizik, sporte dhe shëndet.
Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e edukimit fizik,sporte dhe shëndet”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar; - përdor metoda e teknika që nxisin nxënësit të merren me sport; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin fizik e sportiv të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - përdor metoda sportive në mësimdhënien – nxënien e edukimit fizik; - demonstroi teknika të ndryshme për	- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), nëntor 2018. - Udhëzuesi kurrikular lëndor në edukim fizik, sporte dhe shëndet, në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. - Udhëzuesi kurrikular lëndor në edukim fizik, sporte dhe shëndet në arsimin e

vlërësimin e nxënësit; - shpjegon parimet e hartimit të një testi kontrolli fizik.	mesëm të lartë, dhjetor 2018.
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në edukim fizik, sporte dhe shëndet”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - prezanton materiale të lojërave sportive duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Word; - nxit nxënësit të bëjnë prezantime në edukim fizik, sporte dhe shëndet duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare në lëndën e edukimit fizik, sporte dhe shëndet apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.	- Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. - Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021 - Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie. -

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të	Literatura e rekomanduar
---	--

komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së edukimit fizik, sportedhe shëndet	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i edukimit fizik, sporte dhe shëndet:</i> - dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e edukimit fizik dhe sporteve në klasat 1-9 dhe 10-12; - përshkruan mënyrën e formimit dhe zhvillimit të nxënësve në klasat 1-9 dhe në klasat 10-12; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe të shprehive; - përmirëson marrëdhëniet sociale dhe krijon kushte të jetës për të pasur një shëndet të shkëlqyer; - përdor situata të ndryshme në edukim fizik, sporte dhe shëndet, për të zhvilluar natyrshëm konceptet dhe aftësitë e programeve të klasave 1-9 dhe të klasave 10-12; - mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave të edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit në lidhje shkencat e tjera.	- Programe të lëndës së edukimit fizik, sporte dhe shëndet për mësuesin dhe nxënësin - Materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë. - Librat: Metodika e edukimit fizik; - Didaktika e edukimit fizik; Edukim lëvizor; Lojrat lëvizore dhe edukimi(2004); Anatomi, Fiziologji ushtrimi; Volejbol; Basketbol; Gjymnastike; Atletikë; Futboll, Hendboll.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al